



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 86

Prishtinë, më 16.12.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Ademaj, Armend Zemaj, dhe Agim Aliu.

Munguan: Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami, Pal Lekaj dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office, Arlinda Bajrami-Instituti Gap, Eugen Cakolli-KDI, Lumnije Murati-ZPRK, Visar Rushiti-Gap, Edona Bytyçi-Usaid-CLE, Granit Berisha-praktikant, Dren Ajeti-GLSP, Sanije Berisha-OSCE, Shefki Kastrati-NDI, Zenun Sadikaj, Kushtrim Gjevukaj, Frashër Racaj, Nazmi Maxharri, Musa Korça dhe Florim Xhema-Sindikata e Shërbimit Korrektues.

Stafi mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini;

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26.10. 2016 dhe 7.11. 2016;
3. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;

4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;
6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve Teuta Haxhiu dhe Mytaher Haskuka;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike;
8. Formimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 26.10.2016 dhe 7.11. 2016;

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 26.10.2016 dhe 7.11.2016 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raporteve i Komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;

Albulena Haxhiu, kryetare- Komisioni ka pranuar një rekomandim nga Komisioni për Integritet Evropian, ku i njëjti ka kaluar kompetencat e veta për faktin se ky komision nuk ka të drejtë të bëjë vërejtje kur dihet se çështja e Akademisë së Drejtësisë rregullohet ndryshe në secilin vend, varësisht prej rrethanave dhe nevojave të shtetit. Por megjithatë, ajo u pajtua me vërejtjet e Komisionit për Integritet, ku tha se bëhet fjalë për dy amendamente të Komisionit për Legjislacion, për të cilat shpreson që Komisioni për Legjislacion do ti heq.

Agim Aliu- Projektligji për Akademinë e Drejtësisë ka kaluar gjithë procedurën e nevojshme kohore, kur e dimë rëndësinë që ka ky institucion edhe puna në këtë projektligj është bërë me shumë kujdes dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe partnerë tjerë, siç janë KGJK, KPK, MD OSCE, IGJK dhe gjithashtu me këta partnerë është marre përfundimi për këtë projektligj dhe është miratuar më vonë.

Z. Aliu shprehu habi në rekomandimin e Komisionit për Integritet, ku tha se jo vetëm që kanë kaluar kompetencat por edhe rekomandimi është kontradiktor, kur dihet se kanë kërkuar shkallshmëri të veprave penale e një lloj shkallshmërie e veprave penale ka ekzistuar dhe ekziston.

Aliu pati vërejtje në lajmin që është plasuar në media, ku thuhet se “personat e dënuar kanë të drejtë të jenë pjesë e këshillit drejtues të këtij institucioni”. Ky lajm është krejtësisht i gabuar sepse qëllimi i këtij projektligji ishte që të mos ketë persona inkriminues në organet drejtuese të një institucioni i cili do të merret me drejtësi. Është për keqardhje se pas miratimit në komision nga BE-ja ka ardhur kërkesa se ky projektligj nuk është në plotëni me legjislacionin e BE-së edhe pse përfaqësuesit e kësaj zyre ishin pjesë e konsultimeve, pra shtrohet pyetja pse pas miratimit në komision bëhet një kërkesë e tillë?

Çka do të bëjë zyra e BE-së me ligjet të cilat janë në fuqi dhe të cilat i kanë këto dispozita ose pse Komisioni për Integritet ka lejuar që të kalojnë këto projektligje? Do të duhej të vepronin me korrektësi dhe jo të shkohet në këtë formë, por megjithatë komisioni do të heq këto dy pika dhe pastaj në seancë plenare ky projektligj do të jetë pa këto dy pika.

Armend Zemaj- Është hera e parë që Komisioni për Integritet ka tregu vëmendje në diçka, kur jemi dëshmitar se tash 10 bjet asnjëherë nuk ka pasur një vërejtje, sidomos në ligjet që kanë të bëjnë me pastërti ligjore të personave që punojnë në institucionet e Republikës së Kosovës. Zemaj e dha edhe arsyetimin pse duhet të hiqen këto amendamente dhe njëherësh u pajtua që të hiqen dy amendamentet e kërkuara, në mënyre që ligji të shkojë në seancë plenare për miratim.

Selvije Halimi- Kërkesa nuk është drejtpërdrejt nga Komisioni për Integritet por kjo kërkesë ka ardhur nga Zyra e BE-së, edhe pse gjatë hartimit në grupe punuese prezent ishin edhe përfaqësuesit e BE-së dhe asnjëherë nuk është dhënë ndonjë vërejtje.

Sugjerimi im është që kjo kërkesë të shkojë në Komisionin për Integritet dhe ata pastaj ti referohen Komisionit për Legjislacion.

Halimi tha se në një mbledhje ku ajo ishte pjesëmarrëse, e ku për diskutim patën Ligjin për Partitë Politike, ky ligj është ndryshuar me insistim të BE-së dhe nuk ka qenë i mundur zbatimi i tij, përkatësisht neni ku bëhet fjalë për auditimin e partive politike. Është mirë të merren praktikatat e vendeve tjera, por nuk duhet anashkaluar edhe mendimet e ekspertëve vendorë.

Dren Ajeti- Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka përcjellë punën e grupit punues dhe me heqjen e këtyre sanksioneve nënkuptohet se nëse dikush është dënua për një gjobë të mos ketë të drejtë të kandidohet, që do të thotë në këtë rast, fjalët ku thuhet “gjashtë muaj”, hiqen, që nënkupton se personi dënohet për çdo vepër edhe për gjueti të paligjshme, e cila është e dënueshme gjashtë muaj dhe shtoi se kjo duhet të mbetet, meqenëse edhe është standard me institucionet tjera.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që të heqë amendamentet 12 dhe 22, të Projektligjit 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe lidhur me këtë vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;

Komisioni vendosi që për shqyrtimin e kërkesave buxhetore të Institucioneve/agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, të formojë një grup punues në këtë përbërje:

Armend Zemaj, kryesues
Albulena Haxhiu, anëtare
Agim Aliu, anëtar

Pal Lekaj, anëtar
Danush Ademi, anëtar

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-075 për parandalimin edhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve Teuta Haxhiu dhe Mytaher Haskuka;

Albulena Haxhiu, kryetare, sqaroi qëllimin e kërkesës së dy deputetëve Mytaher Haskuka dhe Teuta Haxhiu, të dy anëtarë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, të cilët kanë kërkuar nga znj. Lirije Kajtazi që në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të thërrasë një mbledhje të komisionit për të shqyrtuar petitionin e qytetarëve që është dorëzuar më 29.11.2016. Kryetarja propozoi që kjo punë ti delegohet Nënkomisionit për Mandate Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit e që kryesohet nga deputeti Armend Zemaj.

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike;

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-119, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk pat vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë;

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe

Ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Formimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore;

Komisioni vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore të formojë një grup punues në këtë përbërje:

Agim Ademaj, kryesues
Albulena Haxhiu, anëtare
Agim Aliu, anëtar
Valdete Bajrami, anëtare

9. Të ndryshme.

Në këtë pikë Komisioni për Legjislacion priti në takim përfaqësuesit e Sindikatës së Pavarur të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Në këtë takim kryetari i kësaj sindikate z. Zenun Sadikaj, në emër të punëtorëve paraqiti kërkesat e kësaj organizate sindikale si vijon:

1. Kërkesë parësore e Sindikatës së Shërbimit Korrektues ishte të ketë ligjin e vet, siç e ka policia, doganat, dhe FSK-ja.
2. Të dihet saktë mosha e pensionimit:55-60-65.(kërkohet që mosha e pensionimit të jetë mosha 55 vjet).
3. A do të llogariten vitet '91-'99 si stazh i punës?(kërkohet që të mos paguhet stazhi për këto vite, por të numërohet si stazh për llogaritjen e viteve të pensionimit).
4. Llogaritja e ditëve të pushimit, (kërkohet që të kenë për 2 vite pune 1 ditë me tepër pushim, pra 2 me 1).
5. Rrezikshmëria në punë, është kërkesë e sindikatës që rrezikshmëria të ndahet në kategori sipas vendit të punës).
6. Të harmonizohet koeficienti.(koeficienti ndryshon në Shërbimin Korrektues, stafin civil)
7. Ushtruesit e detyrës, (kërkohet të paguhen për punën që bëjnë, të mos shkelet Ligji i Punës).
8. Rikthimi, (kërkohet që kategoria e punëtorëve, të cilët janë detyruar të lëshojnë vendin e punës për t'u kujdesur për fëmijët ose pleqtë në familje, t'u mundësohet rikthimi në vendin e punës).
9. Pensionimi, (kërkohet që me rastin e pensionimit, punëtorëve tu jepen 3 paga shtesë).
10. Vdekja e punëtorit, (kërkohet që pas vdekjes së punëtorit, familja të marrë pension).
11. Të emërohet një mbrojtës profesional (avokat, këshilltar ligjor) që të përfaqësojë punëtorët në gjykatë, në rast të ballafaqimit me organe të drejtësisë.
12. Armatimi, (kërkohet që punëtorët e Shërbimit Korrektues të kenë armë për arsye të vetëmbrojtës, në raste të caktuara.)

Albulena Haxhiu - Komisioni për Legjislacion ka vizituar burgjet, por fokusimi ka qenë më tepër tek të drejtat e të burgosurve. Gjithashtu janë parë edhe për së afërmi problemet me të cilat përballet Shërbimi Korrektues. Do të ishte mirë që të ftohen edhe drejtori i Shërbimit Korrektues, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe sindikata që të ballafaqohen para Komisionit për Legjislacion.

Armend Zemaj- Komisioni është i interesuar për problemet që ballafaqohet kjo qendër e mbi të gjitha interesimi është në zbatueshmërinë e Ligjit. Si udhëheqës i Grupit Punues për Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në vitin 2010, në këtë ligj është fut një dispozitë ku numërohet si stazh i punës edhe puna e ndërrimit të natës, mirëpo, ministria nuk ka arritur të nxjerrë një udhëzim administrativ, ku përcaktohet se sa duhet të jete kompensimi.

Komisioni do të merret seriozisht me kërkesat e parashtruara nga Shërbimi Korrektues, kur dihet se çka ndodhë në burgjet e Republikës së Kosovës dhe se së bashku do të punojmë që të krijohen kushte dhe siguri në punë.

Selviqe Halimi- Çështja që ka të bëjë me pezullimin e vendit të punës për arsye të ndryshme është e rregulluar deri diku me Ligjin e punës. Kategoritë si zjarrfikësit, gardianët, policia dhe ushtria, duhet të kenë edhe stazh të beneficuar, për shkak të punës së ngarkuar që kanë dhe për shkak të rrezikshmërisë në punë, pra sa i përket pushimit vjetor, por edhe pensionimit, ndërsa sa i përket pagave, kjo çështje rregullohet me Ligjin për Paga për të gjitha kategoritë që paguhen nga buxheti i Kosovës, ndërsa premtoi mbështetjen e Komisionit për kërkesat e parashtruara të Sindikatës së Shërbimit Korrektues.

Albulena Haxhiu, kryetare- Do të mundohemi që bashkërisht t'i shqyrtojmë dhe adresojmë vërejtjet dhe kërkesat që na janë paraqitur në Komision.

Në fund, deputeti Armend Zemaj, në emër të Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, falënderoi OSCE-në për mbështetje dhe përkrahje me rastin e mbajtjes së punëtorisë dyditore për Rregulloren e Kuvendit, e cila u mbajt më 22-23 nëntor, në Hotelin Dukagjini në Pejë. Po ashtu, ai falënderoi edhe shoqërinë civile dhe partnerët tjerë, të cilët dhanë kontributin e tyre në këtë punëtori.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu